

VENDIM
Nr.469, datë 1.7.1996

PËR VJELJEN E DETYRIMEVE TË SUBJEKTEVE PRIVATE NË SISTEMIN E SHËNDETËSISË

Në zbatim të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Shëndetësisë e të Mbrojtjes së Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Subjektet që kanë dalë në profesion privat në shërbimet shëndetësore të stomatologjisë dhe të rrjetit të hapur të farmacisë, deri në datën 31.7.1996, të shlyejnë, në favor të Buxhetit të Shtetit, detyrimet që kanë kundrejt shtetit për mjetet e punës që kanë privatizuar, qiratë e mjediseve që kanë marrë dhe kanë në posedim, si dhe për ilaçet që kanë marrë në ngarkim me rastin e privatizimit.

2. Degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe detyrohen të përfundojnë, brenda datës 31.7.1996, gjithë dokumentacionin e paraqitur pranë tyre prej drejtorive të shëndetit publik dhe ish-ndërfarmave, që lidhet me privatizimin e mjeteve të punës dhe dhënien me qira të objekteve që kanë në posedim subjektet, sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Përcaktimi i detyrimeve të bëhet duke u bazuar në dokumentet e furnizimeve të bëra me subjektet specialistë që kanë marrë në dorëzim mjetet e punës dhe ilaçet, si dhe vlerësimeve të bëra për caktimin e qirave për objektet që kanë në posedim subjektet e përmendura në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Kur individët debitorë kundrejt drejtorive të shëndetit publik dhe ish-ndërfarmave nuk shlyejnë detyrimet për të cilat kanë marrë njofim, të merren masa detyruese deri në heqjen e licencës profesionale.

5. Në rastet kur subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi nuk kanë likuiduar detyrimet për mjetet e punës që kanë marrë në posedim, qiratë e objekteve që kanë në posedim dhe ilaçet që kanë marrë prej ndërfarmave, degët e Agjencisë Kombëtare të Privatizimit në rrethe dhe drejtoritë e shëndetit publik të ngrenë padi në gjykatë për likuidimin e detyrimeve të papërmblushura që rrjedhin nga marrja në dorëzim e mjeteve të punës, shitja e barnave që kanë marrë në dorëzim, si dhe nga kontrata e qirasë së mjediseve dhe, kur është rasti, të kërkohet edhe zgjidhja e kontratës dhe shpërblimi i dëmit të shkaktuar nga mospërmblushja e detyrimeve.

Për mjediset e punës, për të cilat nuk është lidhur kontratë qiraje, të kërkohet pushimi i posedimit, dorëzimi i mjedisit dhe shpërblim për të gjithë kohën e përdorimit të tij.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ministria e Financave (policia tatimore) Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes së Mjedisit (drejtoritë e shëndetit publik në rrethe) dhe Agjencia Kombëtare e Privatizimit (degët në rrethe), të cilat të rakordojnë ndërmjet tyre punën edhe me organet kompetente ekzekutive të ngarkuara nga dispozitat ligjore në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi